



A.nr.162/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1478/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesja XH.T-G, nga Klina, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.162/2026, e datës 12.02.2026, e parashtruar nga ankuesja XH.T-G, në atë mënyrë që aprovohet pretendimi për klasifikim të pozitës së ankuesit në kategorinë specialist, ndërsa, refuzohet pretendimi ankimor për kompensim retroaktiv të pagës së specialistit.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokoli Nr. 02 Nr.112-22320/25, i datës 22.07.2025, i Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës.

III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore-administrative në kuptim të klasifikimit të pozitës së ankueses në klasën specialist.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, XH.T-G (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 25.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli Nr. 02 Nr.112-22320/25 të datës 22.07.2025, të Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna

e Klinës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë si dhe provat materiale ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 768/2026, të datës 12.02.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin 02Nr.120-2767126 të datës 26.01.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës; Vendimin A.n.1478/2025 të KPMSHCK-së; Akt Emërimit të datës 30.08.2024; Diplomën me Nr. 455 të ankueses; Konkursin RN00012498 për Specialistin e cilësisë së ajrit; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.02.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 24.02.2026; Akt emërimit të datës 26.10.2023; Përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit; Kërkesën të datës 16.01.2026 nga E.M për Q.B; Përgjigjen të datës 23.01.2026 nga DMZP për E.M; Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës Nr.prot.06-18367/2024, të datës 05.06.2024; Tabela e klasifikimit të pozitave të punës në Komunën e Klinës; Listat e pagave nëntor-dhjetor 2023 për ankuesen; Konkursin RN00019046, RN00017927, RN00016985, RN00009881, për pozitën Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit; Ankesën me numër protokolli 5091/2025, të datës 25.07.2027, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli Nr. 02 Nr.112-22320/25 të datës 22.07.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; Vendimin A.nr.834/2025 të datës 09.07.2025 të KPMSHCK; Kërkesën për kalim në kategorinë e specialistëve të datës 28.04.2025; Kërkesën për kalim në kategorinë e specialistëve të datës 22.08.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.08.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 20.08.2025; Kërkesën të datës 08.09.2023; Akt emërimit të datës 26.10.2023; Njoftimin mbi zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së; Konkursin me numër RN00014891 të datës 21.08.2024; Katalogun e vendeve të punës në Komunën e Klinës; Listën e pagave në Korrik 2025; Listën e pagave në Qershor 2025; Vendimin Nr.112/1464/2024 të datës 11.04.2024; Vendimin Nr.112-23786/2024, të datës 30.07.2024; Vendimin Nr.prot.06-18367/2024, të datës 05.06.2024; Tabela e klasifikimit të pozitave të punës në Komunën e Klinës; Organogrami i Komunës së Klinës-2024; Provat shtesë të datës 21.11.2025 së bashku me sqarimin dhe përshkrimin e detyrave të punës së ankueses, kërkesa e KPMSHCK-e drejtuar DMZP-se të datës 03.12.2025, emaili rikujtues i KPMSHCK-se për DMZP të datës 18.12.2025 dhe emaili i datës 18.12.2025 nga Drejtorit i DMZP-së për KPMSHCK-ën.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses ***është pjesërisht e bazuar, sepse:***

I. Vlerësimi gjendjes së fakteve:

- Ankuesja sipas Akt-it të emërimit me Nr. Protokolli 02-112-29436/2024, të datës 30.08.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare për Mbrojtje të Mjedisit* në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit-Sektori për Ndërtim dhe Banim, Komuna e Klinës.
- Ankuesja më datë 22.04.2025, përmes postës elektronike parashtron kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, për sistematizimin e pozitës së saj në kategorinë Specialist, me klasë

dhe koeficient të pagës GJ13/(6.52), ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, përmes përgjigjes në kërkesë të datës 28.04.2025, ka njoftuar ankuesen se DMZP-ja dhe Thesari nuk e kanë zbatuar kërkesën lidhur me klasifikimin e pozitës suaj në kategorinë specialist.

-Ankuesja më datë 06.05.2025, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK, që ti mundësohet klasifikimi i pozitës së saj të punës nga kategoria profesionale 2 me koeficient GJ37 (4.9) në kategorinë Specialist Gj13 me koeficient të pagës 6.52.

-KPMSHCK-ja më Vendimin A.nr.834/2025, të datës 07.07.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses të datës 06.05.2025, dhe ka detyruar organin e punësimit që të rishqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 22.04.2025, dhe të nxjerrë akt administrativ.

-Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës në zbatim të vendimit të KPMSHCK-së me numër A.nr.834/2025, të datës 07.07.2025, më Vendimin Nr.112-22320/2025, të datës 22.07.2025 ka refuzuar kërkesën e ankueses si të pabazuar.

- Ankuesja sërish ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimin Nr.112-22320/2025, të datës 22.07.2025, me pretendimin ankimor që t'i mundësohet klasifikimi i pozitës së saj të punës nga kategoria profesionale 2 me koeficient GJ37 (4.9) në kategorinë Specialist Gj13 me koeficient 6.52.

- KPMSHCK-ja më Vendimin A.nr.1478/2025, të datës 09.01.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses të datës 06.05.2025, ka anuluar Vendimin Nr.112-22320/2025, të datës 22.07.2025, dhe ka obliguar Njesisë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që të rishqyrtoj çështjen e ankueses në pikëpamjet e arsytimit të këtij vendimi.

- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës më datë 26.01.2026, ka nxjerr Vendim 02Nr.120-2767126, me të cilin ka refuzuar në tërësi kërkesën e datës 22.04.2025 të parashtruar nga ankuesja, me arsyetimin se bazuar edhe në mendimin këshillimor të DMZP-së, gjatë përcaktimit të pozitave në kategori dhe klasën specialist duket pas parasysh se nëpunësve aktual nuk mund të t'iu ndryshohet kategoria tjetër aktuale në kategorinë e specialistit duke arsyetuar tutje se pozita të cilën ankues e mban është rekrutuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa pozita e ankueses është paraparë profesional 2 edhe më rregulloren e brendshme, kështu që pozita të cilën e mban ankuesi nuk bënë pjesë në pozitë që kërkojnë njohuri të thella profesionale.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin 02Nr.120-2767126, të datës 26.01.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, me pretendimin se vendimi i kundërshtuar është nxjerr pa bazë faktike dhe juridike, duke pretenduar se po i mohohet e drejta për kategorizim si Specialiste edhe pse konsideron që plotëson kërkesat e përgjithshme formale për këtë. Tutje, shton se edhe në konkursin ku është përzgjedhur ka qenë emërtimi i grupit Specialist i Cilësisë së Ajrit, kështu që, vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar, të detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës të nxjerr akt të ri për klasifikimin në

kategorisë e specialistëve GJ13 më koeficientin 6.52, përkatësisht 7.52, si dhe kërkon që të obligohet Komuna e Klinë që diferencën e pagës ta kompensoj në mënyrë retroaktive nga muaji nëntor 2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua ju referua bazës ligjore si me poshtë:

I. Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

-Neni, 2 paragrafi 1: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*,

-Neni 14, paragrafi 3, të: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.*

II. Ligji Nr.08-L-197 për Zyrtarët Publikë

-Neni 38, paragrafi 2: *: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatorë, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional''*

II. Rregullorja (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil:

-Neni 8: *Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje, (më Shtojcën Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është përcaktuara: "Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave", kurse si kushte formale për këtë kategori janë paraparë: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, tekologji, pylltari, bujqësi, veterinar, gjeografi, **ambient**, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtime arsimore.*

-Neni 34: *Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.*

Rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e kategorizuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Andaj, mbi bazën e këtij përcaktimi, Kolegji sjell në vëmendje faktin se pozita specialist është vendosur si kategori e veçantë e shërbimit civil, ku në kuadër të së cilës kategori hyjnë pozita që kërkohet përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara më Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kështu që, edhe kategorizimi i një pozite behët në varësi të faktorëve dhe karakteristikave të përshkrimit të detyrave të punës së një pozite respektive siç parashihet me nenin 18 të kësaj rregullore.

Nisur nga konstatimi si më sipër, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur sipas përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Mbrojtjes së Mjedisit, si detyra kryesore janë: *Harton dhe zhvillon plane e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave; Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës; Planifikon dhe propozon, masa dhe aktivitete si dhe siguron zbatimin e tyre me qëllim të avancimit të punës dhe efikasitetit për procesin e mbrojtjes së mjedisit; Kujdeset për nivelin e ndotjes së ajrit, ujit dhe dheut, inspektimin e mbeturinave e materieve të rrezikshme që shkaktohen nga veprimtaritë industriale, urbane dhe rurale; Monitoron shërbimet publike komunale, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, kanalizimit, ujit dhe shërbimeve tjera publike për parandalimin e ndotjes së ambientit; Bënë hulumtime dhe analiza për mungese në menaxhimin dhe eksplotimit të resurseve natyrore dhe shqyrton rezultatet e hulumtimeve, të përmbajtjeve, analizave lidhur me gjendjen e mjedisit; Merr pjesën e planifikimit lokal të mjedisit, masave tjera mbrojtëse ndaj zhurmës dhe trafikut; kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshëm dhe me kohë nga mbikëqyrësi.*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit detyrat e punës për pozitën Zyrtar i Mbrojtjes së Mjedisit kërkojnë njohuri dhe përgatitje specifike në fushën e mjedisit, sepse detyrat e pozitës përkatëse i referohen inspektimeve dhe analizave lidhur me ndotje të ajrit, ujit dhe dheut dhe monitorime të shërbimeve publike në kuptim të respektimit të ligjit dhe standardeve/masave në mbrojtje të mjedisit, detyra këto që mund të ushtrohen vetëm nga zyrtarët që posedojnë njohuri dhe kualifikime arsimore të fushës së mjedisit, andaj, në vlerësim të Kolegjit më të drejtë pala ankuese pretendon se pozita e saj e punës si zyrtar i Mbrojtjes së Mjedisit duhet të duhet të klasifikohet si pozite e specialistit.

Lidhur me qëndrimin e organit të punësimit se bazuar në mendimin këshillues të DMZP-ës së gjatë përcaktimit të pozitave në kategori dhe klasën specialist duket pas parasysh se nëpunësve aktual nuk mund të t'iu ndryshohet kategoria tjetër aktuale në kategorinë e specialistit duke arsyetuar tutje se pozita të cilën ankues e mban është rekrutuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publikë, një qëndrim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore sepse kategoria specialiste është paraparë si kategori e veçantë

vetëm më Ligjin Nr.08-L-197 për Zyrtarët Publikë, andaj, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji (26 shtator 2023) të gjitha institucionet që kanë nëpunës civil kanë qenë të detyruar që të përfundojnë klasifikimin e pozitave në pajtim të plotë me këtë ligj. Kurse, lidhur me pretendimin kur një pozitë është e klasifikuar në një kategori të caktua me rregullore të brendshme të institucionet, atëherë, institucioni gjegjes ka për obligim sikurse në rastin konkret që të ndërmerr veprime ligjore administrative në kuptim të rregullimit të klasifikimit respektiv.

Përkitazi me pretendimin për kompensim retroaktiv, Kolegji thekson faktin së një pretendim i tillë nuk është i bazuar, sepse, ankuesja ende nuk e ka të njohur të drejtën e klasifikimit të pozitës së saj si specialist, andaj, edhe efekte e klasifikimit rrjedhin vetëm nga data e miratimit të klasifikimit e jo në mënyrë retroaktive siç pretendon pala ankuese.

Thënë si më lart, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.162/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses XH.T-G;
- Kryetarit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.